



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 77.3 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe paragrafit 3 dhe 4 të nenit 6 të Rregullës Zgjedhore Nr.19/2016, për Këshillat e Vendvotimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 20.09.2021, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Kryesuesve të Këshillave të**  
**Vendvotimeve (KVV për Zgjedhjet Lokale 2021**



- I. Miratohet Rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore për përbërjen e Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për zgjedhjet lokale 2021.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 20.09.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Data/Datum 17.09.2021

Për/Za Këshillin për Operacione Zgjedhore / Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Permes/Preko Burim Ahmetaj, Kryshf Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së

Nga/Od Nexhmedin Hyseni, Drejtor i Departamentit të Koordinimit në Terren

Kopje/Kopija Arkivës / KKZ-ve

Lënda/Predmet **Rekomandim për përberjen e Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve për Zgjedhjet Lokale 2021**

Të nderuar Anëtar,

Bazuar në aktivitetin Nr.213, 214 dhe 215 të paraparë në Planin Operacional të Zgjedhjeve Lokale 2021, Sekretariati i KQZ-së me datë 15 shtator 2021 ka bërë Ftesën për Subjektet Politike lidhur me nominimet për Anëtar të Këshillave të Vendvotimeve për Zgjedhjet Lokale të 17 tetorit 2021. Gjithashtu, KQZ tashmë ka miratuar dhe numrin e përberjes së KVV-ve për Zgjedhjet Lokale të 17 tetorit 2021, që Subjektet Politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe nëpër Kuvendet Komunale, të cilat garojnë në Zgjedhjet aktuale, do të propozojnë personat për Anëtar të KVV-ve. Andaj, KKZ, respektivisht Departamenti i Koordinimit në Terren me qëllim të ndarjes së drejtë, për ndarjen e pozitave të Kryesuesve nëpër vendvotime, në interpretim të drejtë të normave juridike për dispozitat e parapara ligjore (në secilën komunë me specifikat përkatëse) sipas certifikimit të SP-ve në komunat përkatëse, dhe përfaqësimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës si dhe në përshtatshmëri me specifikat në komunat përkatëse rekomandojmë si në vijim:

- Përberja e Kryesuesve për Këshillat e Vendvotimeve në Zgjedhjet Lokale të 17 tetorit 2021, **rekomandojmë të bëhet** sipas paragrafit 3 të nenit 77 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe paragrafit 3 dhe 4 të nenit 6 të Rregullës Zgjedhore 19/2016, për Këshillat e Vendvotimeve, dhe kur nenet paraprake nuk mund të plotësohen, atëherë KKZ respektivisht KQZ mund të përdorë formulë tjetër në rastet specifike kur nuk kemi përfaqësim të kualifikuar nga subjektet politike, sipas dispozitave ligjore si në lartë shënim.
- Kryesuesit e Vendvotimeve janë nga: LVV, PDK, LDK, AAK dhe Lista Serbe, kurse në komunat specifike, përdoret formula tjetër proporcionale për subjekt politike në përputhje me rezultatet e fundit për Kuvendin e Kosovës sipas fuqisë politike nga ajo komunë, apo dhe KKZ.

Me respekt!